

FJALË PËRSHËNDETËSE E KRYETARES SË FORUMIT TË GRAVE MUSLIMANE NË KREUZLINGEN, ZNJ. ZULKEFLIE NUREDINI

- KONCERTI ISLAM 05.02.2017 -

Të nderuara zonja, të nderuar zotërinj

Vëllezër dhe motra, es-selamu alejkum ve rahmetullahi ve berakatuhu

Kam nderin që në emër të Forumit të Grave Muslimane në Kreuzlingen t'ju dëshiroj mirëseardhje në koncertin e **katërt** islam të organizuar nga Xhamia jonë "Hëna e re" në Kreuzlingen.

Që nga themelimi i Forumit tonë më **1 nëntor 2015** e deri më sot ne jemi munduar t'i realizojmë synimet dhe projektet tona që i patëm përcaktuar me rastin e themelimit të Forumit të Grave Muslimane në Kreuzlingen.

Kështu:

Më **5 mars 2016** organizuam ligjëratën ekstra për gratë me magj. Zeliye Sulejmani-Bunjakun me temën "Gruaja dhe Islami".

Më **20 maj 2016** në bashkëpunim me Femmes Tische dhe Perspektive Thurgau ne e realizuam një ligjëratë interaktive me nënat në temën "Si t'ia mësoj një lojë fëmijës tim?".

Më **29 maj 2016** bashkë me kryesinë e xhamisë sonë, me xhaminë e turqve dhe me shkollën shqipe organizuam shëtitjen për fëmijët në kopshtin zoologjik në Cyrih.

Më **7 qershor 2016** bashkë me kryesinë e xhamisë dhe me Forumin e të Rinjve ne organizuam iftarin e përbashkët tradicional në xhaminë tonë, ku mysafir e patëm myftiun e Tetovës Dr. Qani ef. Nesimin.

Më **12 qershor 2016** ligjëratë për gratë me Emine Sopin.

Më **19 qershor 2016** ligjëruese enkas për gratë patëm teologen Nermine Nuhiun.

Më **26 qershor 2016** patëm ligjëratë për gratë me hafize Emine Sopin.

Më **3 korrik 2016** ne organizuam tribunën fetare me magjistren Zeliye Sulejmani-Bunjaku.

Më **15 gusht 2016** ne morëm pjesë në aksionin për tubimin e ndihmave humanitare për të prekurit nga vërshimet në Hasanbeg të Shkupit. Me këtë rast ne e vizituam edhe një familje nga Kreuzlingeni e cila e kishte përjetuar shumë keq tmerrin e kësaj vërshime bashkë me fëmijët e tyre. Shyqyr Zotit, ata janë shëndosh e mirë!

Më **18 shtator 2016** në kuadër të Qendrës për Dialog Ndërfetar në Kantonin Thurgau (Interreligiöser Arbeitskreis im Kanton Thurgau) ne si Forum i grave morëm pjesë në festën e Falënderimeve që u mbajt në xhaminë tonë, ku patëm përgatitur edhe ëmbëlsira për të pranishmit.

Më **2 tetor 2016** bashkë me kryesinë e xhamisë dhe me Forumin e të rinjve ne e festuam vitin e ri hixhrij, me ç'rast ne përgatitëm ëmbëlsira për të pranishmit, kurse me nxënësit e xhamisë ne përgatitëm dhe poqëm biskota (Güetzli) ekstra për vitin e ri islam.

Më **30 tetor 2016** organizuam tribunën për gratë me ligjëruesen hafize Emine Sopi me temën "Ura e fortë mes fëmijës dhe prindit – komunikimi i vazhdueshëm".

Më **13 nëntor 2016** në kuadër të "Javës së feve" që në Kreuzlingen organizohet nga Tryeza e Rrumbullakët e feve ne si Forum morëm pjesë në darkën ndërfaqetare ku ne bashkë me gratë e xhamisë së turqve në Kreuzlingen përgatitëm "Ashure" për afro 60 persona.

Më **27 nëntor 2016** ne e festuam njëvjetorin e themelimit të forumit tonë me ç'rast raportuam për veprimtarinë tonë njëvjeçare. Në këtë takim ligjëruese e patëm zonjën Yasemin Duran nga Aargau e cila në gjuhën gjermane ligjëroi për temën "Të jesh muslimane në shoqërinë e sotme".

Më **27 janar 2017** organizuam një ligjëratë enkas për vajzat nga mosha 12-18 vjeç me temë "Cybermobbing" (mobbingu në internet).

Në klasën e xhamisë sonë tre herë në javë vijohet mësimi i Kur'anit për gratë e rritura e të moshuara me mual-limen Ibadet Neziri. Së shpejti do të mbahet edhe ceremonia e hatmes së 12 grave që e kanë përfunduar mësimin dhe leximin e Kur'anit.

Po ashtu, çdo të enjte, me mësuesen Eva Köbel-Bosshard, në xhaminë tonë zhvillohet një kurs i gjuhës gjermane për gratë e moshuara.

Ne shpresojmë që sa më shumë gra nga Kreuzlingeni dhe rrethina të na bashkëngjiten në punën tonë në mënyrë që të jemi sa më efikase në synimet dhe projektet tona. Ngelim me shpresën që mbështetja juaj nuk do të mungojë.

Përndryshe, aktivitetet tona mund t'i ndiqni te web faqja e xhamisë sonë "el-hikmeh.net" si dhe në faqen e Facebookut "Xhamia Hëna e re në Kreuzlingen".

Për fund, ju dëshirojmë të kaloni çaste të këndshme në këtë koncert islam.

Ves-selamu alejkum ve rahmetullah.